R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.3121/1 prot. Tiranë më 15.12.2025

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË ARSIMIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "*Zyra e Komisionerit*") ka administruar shkresën tuaj me nr. 7604/2 prot., datë 02.12.2025, protokolluar me tonën me nr. 3121 prot., datë 04.12.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin "*Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara",* së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe materialeve përkatëse, konstatohet se ky projektvendim ka për qëllim krijimin dhe rregullimin e funksionimit të një baze të dhënash për provimet e shtetit dhe provimet e tjera të digjitalizuara. Duke marrë parasysh gamën e gjerë të të dhënave personale që do të përpunohen në këtë sistem, disa dispozita kërkojnë saktësim për të garantuar përputhshmërinë me ligjin nr.124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" (në vijim "*Ligji*"). Më konkretisht, propozojmë të mbahen në konsideratë komentet dhe sugjerimet, si më poshtë vijon.

Për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, është thelbësore të përcaktohet qartë baza ligjore që legjitimon "*Qendrën e Shërbimeve Arsimore*" në cilësinë e Kontrolluesit, që përpunon të dhënat personale në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 7, të Ligjit. Vërejmë që kjo bazë ligjore mungon edhe në pjesën hyrëse, mbi të cilën mbështetet hartimi i këtij projektvendimi.

Referuar përmbajtjes së projektvendimit, është parashikuar se "*Sistemi i Provimit të Shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara*" do të ndërveprojë ndër të tjera edhe me sistemet elektronike ekzistuese të palëve të treta si, e-Albania dhe Regjistri Elektronik Kombëtar për të Huajt në Republikën e Shqipërisë.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, ndërveprimi i këtij sistemi me sisteme dhe regjistra të palëve të treta legjitimohet vetëm nëse është e parashikuar në legjislacionin specifik, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit.

Ndërkohë në projektvendim nuk parashikohet një parim i qartë i cili ka si qëllim mbrojtjen e të dhënave personale gjatë administrimit të provimeve. Përfshirja e një dispozite të tillë është e domosdoshme për të garantuar përgjegjësi institucionale.

Gjithashtu, vërehet se projektvendimi nuk parashikon parimin e minimizimit të të dhënave, i cili është thelbësor bazuar në pikën 3 të nenit 6 të Ligjit, duke specifikuar që do të përpunohen vetëm të dhënat e domosdoshme për qëllimin e përcaktuar.

Kështu, sugjerojmë që ***pas pikës 5 të projektvendimit të shtohet një pikë e re,*** me këtë përmbajtje "*Institucioni administrues i bazës së të dhënave siguron përpunimin e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Institucioni administrues mbledh vetëm të dhënat personale të domosdoshme për realizimin e qëllimit të bazës së të dhënave dhe provimeve*."

Në vijim, konstatohet se ***në pikën 6 të projektvendimit***, e cila lidhet me ruajtjen e të dhënave, mungon përcaktimi i afateve konkrete të ruajtjes si dhe i procedurave të anonimizimit ose shkatërrimit të tyre pas përfundimit të këtyre afateve.

Në këtë këndvështrim sugjerojmë që institucioni administrues i sistemit të përcaktojë fillimisht afatin e ruajtjes së të dhënave, në përputhje me qëllimin e përpunimit dhe legjislacionin e fushës. Ndërkohë pas fjalisë së pikës 6 të shtohet dhe fjalia me këtë përmbajtje "*...Pas përfundimit të këtij afati, të dhënat fshihen ose anonimizohen sipas procedurave të institucionit administrues*."

Më tej, bazuar në nenin 28 të Ligjit, Zyra e Komisionerit sugjeron që ***përmbajtja e pikës 9 të projektvendimit,*** të riformulohet sipas paragrafit *"9. Palët zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, për çdo veprim në regjistër lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin gjurmueshmërisë, konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit."*

Ndërkohë, duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e gjerë të përpunimit të të dhënave në këtë sistem, sugjerojmë kryerjen e "*Vlerësimit të Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave*". Ky detyrim kërkohet, jo vetëm si një standard evropian i përcaktuar në Rregulloren e BE-së (GDPR) por edhe në përputhje me nenin 31, të Ligjit nr.124/2024, me qëllim rritjen e sigurisë, transparencës, përgjegjshmërisë si dhe të drejtën e privatësisë së qytetarëve.

Edhe pse ky detyrim në zbatim të pikës 2 të nenit 101 të Ligjit, hyn në fuqi në shkurt të vitit 2027, rekomandojmë që për shkak të rëndësisë të këtij procesi të merret në konsideratë zbatimi i këtij detyrimi që në momentin e projektimit të sistemit.

Në përfundim, sugjerimet e mësipërme sjellin një zbatim më efektiv të legjislacioneve respektive, duke kontribuar në sisteme të qëndrueshme dhe funksionale, në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi